

SKEDË INFORMUESE

Thirrje e hapur për projekte për Bashkitë “ProCleanLakes Call for Associated Regions” nën Programin Horizon Europe

Synimi i thirrjes:

Qëllimi i thirrjes është të zgjerohet ndikimi i projektit ProCleanLakes nëpërmjet riprodhimit, shkallëzimit dhe zbatimit të zgjidhjeve inovative për restaurimin dhe mbrojtjen e liqeneve natyrore evropiane. Kjo do të realizohet përmes krijimit të një plani veprimi të bazuar në shkencë, i cili do të integrojë rezultatet dhe njohuritë e grumbulluara në një Plan Veprimi pan-evropian.

Prioritetet e thirrjes:

- Përmirësimi i statusit ekologjik dhe kimik të liqeneve natyrore evropiane, duke përfshirë biodiversitetin dhe duke përdorur zgjidhje të reja integruese të bazuara në natyrë;
- Përdorimi i zgjidhjeve të reja dixhitale 4.0 për të mbështetur monitorimin, restaurimin, mbrojtjen dhe transferimin e njohurive të ekosistemit në rajone të tjera;
- Mundësimi i aktiviteteve të biznesit bazuar në konceptin e ekonomisë qarkulluese, duke siguruar kalimin nga ekonomia blu në atë të gjelbër;
- Rritja e ndërgjegjësimit, fuqizimi, ndërtimi i kapaciteteve dhe zhvillimi i përbashkët i zgjidhjeve me qytetarët dhe palët e interesuara në lidhje me problemet dhe sfidat që lidhen me restaurimin dhe mbrojtjen e liqeneve natyrore evropiane.

Rezultatet e pritshme:

- Hartimi i një “roadmap” për restaurimin dhe mbrojtjen e liqeneve natyrore.
- Riprodhimi dhe shkallëzimi i zgjidhjeve të testuara në vendet e demonstrimit.
- Përmirësimi i cilësisë ekologjike dhe shtimi i biodiversitetit.
- Angazhimi i komuniteteve lokale dhe transferimi i eksperiencës në nivel pan-evropian.

Aktivitetet e pranueshme:

- Organizimi dhe pjesëmarrja në trajnime, workshop-e, takime të terrenit dhe konsultime me palët e interesuara.
- Kryerja e aktiviteteve praktike për riparimin e liqeneve (p.sh., vendosja e zonave mbrojtëse, implementimi i zgjidhjeve për filtrim dhe monitorim të ujërave).
- Bashkëpunimi me partnerët e ProCleanLakes për adaptimin e rezultateve dhe integrimin e tyre në një plan veprimi të përbashkët.

Kush mund të aplikojë :

- Thirrja pranon projekt-propozime vetëm nga **autoritetet vendore dhe rajonale**, që janë përgjegjëse për menaxhimin, rregullimin ose mbikëqyrjen e burimeve ujore, duke përfshirë liqenet dhe ujëmbledhësit e liqeneve, brenda

juridiksioneve të tyre përkatëse (p.sh. departamentet lokale të ujit të Bashkive, Drejtoritë e Ujitjes dhe Kullimit, etj.), nga rajonet e asociuara, ku Shqipëria është pjesë dhe që nuk janë akoma pjesë e konsorciumit të ProCleanLakes.

Çfarë konsorciumi pranohet:

Aplikimi mund të bëhet si entitet i vetëm ose në bashkëpunim (konsorcium), ku autoriteti vendor/rajonat vepron si partner kryesor (Lead partner).

Cili është buxheti i thirrjes dhe si është ndarë në prioritet:

- Financimi jepet në formën e një grant-i lump sum.
- Për secilin projekt, financimi fillon nga shuma minimale **60.000 Euro** dhe mund të arrijë deri në shumën maksimale **100,000 Euro**.
- Numri i projekteve që do të financohen: **3 - 5**
- Norma e financimit: **100 %** (nuk ka nevojë për bashkëfinancim)

Si bëhet aplikimi:

Aplikimi realizohet përmes dorëzimit të dokumentacionit sipas formatit specifik të thirrjes:

- Formulari i aplikimit (Annex 1)
- Dokumenti i buxhetit (Annex 2)

Të gjitha dokumentet duhet të dërgohen në anglisht nëpërmjet emailit në adresat: rodiefros@aua.gr dhe anca.stoica@boku.ac.at

Kur është afati i fundit:

- Afati i fundit i aplikimit: **31 Mars 2025** (ora 17:00 CET).

Linku i thirrjes: <https://projects.research-and-innovation.ec.europa.eu/en/funding/funding-opportunities/funding-programmes-and-open-calls/horizon-europe/eu-missions-horizon-europe/restore-our-ocean-and-waters/procleanlakes-call-associated-regions>

Nëse keni nevojë për më shumë informacion ose ndihmë shtesë mbi këtë thirrje, na njoftoni!